



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“TEKSTIL-KONFEKSIONE”

D-II-22

Niveli i dytë në KSHK¹, referuar nivelit II në KEK²

Tiranë, Nëntor 2022

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	TEKSTIL-KONFEKSIONE			Kodi
Kohëzgjatja	1900-2100 orë	Niveli	II në KSHK, referuar nivelit II në KEK	D-II-22
Qëllimi:	Qëllimi i kualifikimit profesional “Tekstil-konfeksione”, niveli II në KSHK, referuar nivelit II në KEK, është përgatitja e individëve për t’u punësuar si ndihmës, në profesione që lidhen drejtpërdrejt me fushën e tekstil-konfeksionit dhe zhvillimi i personalitetit të tyre për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	Në institucionet e arsimit dhe formimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional në “Tekstil-konfeksione”, niveli II në KSHK, referuar nivelit II në KEK, kanë të drejtë të hyjnë të gjithë individët që: - kanë mbaruar arsimin e detyruar 9-vjeçar; - janë në kushte shëndetësore që e lejojnë kryerjen e detyrës për përballimin e kërkesave të këtij niveli të arsimit profesional. Pranohen edhe individë që kanë aftësi ndryshe, për të cilët ofruesi i kualifikimit krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me aftësitë e tyre.			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Tekstil-konfeksione”, niveli II në KSHK, referuar nivelit II në KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe Supplementin e Certifikatës Profesionale të nivelit, të punonjësit gjysmë të kualifikuar (ndihmës) në këtë drejtim, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ky kualifikim i jep individit mundësinë që t’i drejtohet tregut të punës për t’u punësuar si ndihmës në sipërmarrje të ndryshme të prodhimit të veshjeve apo në punishte të ndryshme artizanale, si dhe në veprimtari të tjera që ushtrohen në këtë drejtim. Me përfundimin e kualifikimit “Tekstil-konfeksione”, niveli II në KSHK, referuar nivelit II në KEK, individi ka të drejtë të vazhdojë arsimimin në nivelin III në KSHK të kualifikimit profesional në një nga profilet mësimore të “Tekstil-konfeksione”. Me vijimin e mëtejshëm të arsimit profesional në nivelin IV në KSHK, referuar nivelit IV në KEK si teknik /menaxher i mesëm, ai/ajo fiton të drejtën e diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale” me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe/ose universitare.			
Data e validimit	<i>Korrik 2023</i>			
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	Tekstil-konfeksione, niveli II në KSHK D-I-11; D-II-17;			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

Në përfundim të kualifikimit profesional “Tekstil-konfeksione” niveli II në KSHK, referuar niveli II të KEK, individi zotëron njohuritë profesionale si më poshtë:

NJOHURI

Komunikimi, etika profesionale dhe edukimi i karrierës

- Të përshkruajë rëndësinë e informimit para fillimit të punës;
- Të përshkruajë parimet kryesore të etikës profesionale në punë;
- Të listojë metodat e komunikimit duke përshkruar rëndësinë e tyre;
- Të listojë parimet e punës në grup dhe rëndësinë e tij;
- Të përshkruajë rregullat e higjienës dhe mirëmbajtjes së mjeteve të punës, pajisjeve dhe vendit të punës;
- Të përshkruajë rregullat e përdorimit të mjeteve, pajisjeve dhe makinerive në repartet e prodhimit;
- Të përshkruajë rëndësinë e përditësimit të informacionit mbi zhvillimin e industrisë së tekstileve përkrah evolucionit njerëzor;
- Të përshkruajë qasjet/metodat për zgjidhjen e konflikteve;
- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në marrëdhënie pune;
- Të përshkruajë rëndësinë e vlerësimit, vetëvlerësimit, motivimit dhe vetë motivimit.

Tekstile për veshje dhe artikuj të tjerë

- Të përshkruajë konceptin e fibrave dhe klasifikimin e tyre;
- Të listojë produktet e marra nga fibrat;
- Të listojë karakteristikat të fibrave tekstile (pambuk, lesh, fibra artificiale, fibra sintetike etj.);
- Të përkufizojë nocionin fill, karakteristikat dhe përdorimet e tij;
- Të përshkruajë proceset kryesore në filaturë;
- Të përshkruajë procesin e formimit të pëlhurave në makinat e tezgjahut;
- Të listojë llojet kryesore të thurjeve në makinat e tezgjahut;
- Të përshkruajë procesin e formimit të pëlhurave në makinat e trikotazhit;
- Të listojë llojet kryesore të thurjeve në makinat e trikotazhit;
- Të listojë llojet dhe rëndësinë e proceseve përfundimtare të pëlhurave;
- Të përshkruajë proceset dhe metodat e trajtimit përfundimtar të pëlhurave (zbardhja, mercerizimi);
- Të rendisë teknikat e ngjyritimit të tekstileve;
- Të rendisë teknikat e stampimit të pëlhurave;

- Të përshkruajë teknikat e manipulimit të tekstileve;
- Të përshkruajë rëndësinë e dallimit të anës së përparme të pëlhurave;
- Të listojë llojet e defekteve në tekstile;
- Të rendisë llojet e lëkurëve;
- Të përshkruajë mënyrat e prodhimit të lëkurëve sintetike dhe artificiale;
- Të përshkruajë mënyrat e përpunimit të lëkurëve të marra nga kafshët;
- Të përshkruajë dallimet midis llojeve të ndryshme të lëkurëve;
- Të listojë vetitë fiziko-mekanike të lëkurëve;
- Të rendisë artikujt e prodhuar nga lëkura;
- Të përshkruajë karakteristikat e lëkurëve për prodhimin e veshjeve dhe artikujve të tjerë;
- Të përshkruajë standardet e kushteve teknike të tekstileve;
- Të klasifikojë llojet e ndryshme të tekstileve dhe përdorimi i tyre.

Bazat e modelimit

a. Matjet

- Të listojë pikat antropometrike të trupit të njeriut sipas standardit;
- Të përshkruajë proporcionet e trupit të njeriut;
- Të përshkruajë diferencat e gjatësisë shpinë-përparëse;
- Të përshkruajë mënyrat e marrjes së përmasave të trupit të njeriut;
- Të rendisë format dhe defektet në trupin e njeriut;
- Të përshkruajë elementët e tabelave të masave;
- Të listojë pikat bazë për marrjen e përmasave të artikujve të tjerë sipas standardeve përkatës;
- Të përshkruajë mënyrat e marrjes së përmasave të artikujve të tjerë.

b. Ndërtimi kallëpeve

- Të përshkruajë mënyrat e llogaritjes së sasisë së nevojshme të materialeve për ndërtimin e skicave;
- Të përshkruajë mënyrat e llogaritjes së përmasave të artikujve/objekteve;
- Të përshkruajë mënyrat e interpretimit të tabelave të masave;
- Të përshkruajë rëndësinë e përfshirjes së tolerancave të lirshmërisë në llogaritje;
- Të përshkruajë llojet e tolerancave të qepjes dhe rëndësinë e tyre në skicë;
- Të përshkruajë teknikat dhe rëndësinë e vendosjes së shenjave orientuese;
- Të përshkruajë mënyrat e skicimit të qemerëve;
- Të përshkruajë mënyrat e skicimit të xhepave dhe kapakëve;
- Të përshkruajë mënyrat e skicimit të fundeve;
- Të përshkruajë mënyrat e skicimit të pantallonave;
- Të përshkruajë mënyrat e skicimit të busteve;
- Të përshkruajë mënyrat e skicimit të mëngës së thjeshtë;
- Të përshkruajë mënyrat e skicimit të jakave;

- Të përshkruajë mënyrat e skicimit të këmishëve;
- Të përshkruajë mënyrat e skicimit të fustanit;
- Të përshkruajë mënyrat e skicimit për artikuj të tjerë (perde, çanta, kapele, doreza etj.);
- Të klasifikojë llojet bazë të manekinëve;
- Të përshkruajë mënyrat e përgatitjes së pëlhurës direkt në manekinë (mulazh);
- Të përshkruajë mënyrat dhe rëndësinë e llogaritjes së tolerancave për artikuj të tjerë;
- Të përshkruajë mënyrat dhe rëndësinë e vendosjes së shenjave orientuese mbi skicat e artikujve të tjerë.

c. Prerja

- Të përshkruajë terminologjinë e duhur profesionale të modelimit;
- Të përshkruajë mënyrën e zhvendosjes së pencës së supit në pozicione të ndryshme;
- Të përshkruajë mënyrat e prerjes së tekstileve në bazë të llojit të tekstit, trashësisë së tij dhe sasisë së produktit;
- Të përshkruajë rëndësinë e ekonomizimit të tekstit;
- Të përshkruajë rëndësinë e drejtimit të pëlhurës në funksion të produktit;
- Të rendisë mënyrat e palosjes së tekstit;
- Të përshkruajë mënyrat e vendosjes së pëlhurës mbi tavolinën e prerjes;
- Të përshkruajë rëndësinë e vendosjes dhe fiksimit të kallëpit mbi tekstile;
- Të përshkruajë teknikat për prerjen e tekstit sipas kallëpit;
- Të përshkruajë rëndësinë e përzgjedhjes së mjeteve të punës për prerjen e tekstit sipas kallëpit.

Qepja dhe proceset përfundimtare

- Të përshkruajë rëndësinë e përzgjedhjes së mjeteve dhe materialeve në proceset e qepjes me dorë, sipas llojit të tekstit;
- Të listojë punimet me dorë (pe-kopjues apo pasi, ildisje, zig-zag, nevert, punime birash, qepje kopsash etj.);
- Të përshkruajë rëndësinë e përgatitjes së makinës qepëse dhe vendit të punës sipas proceseve;
- Të përshkruajë teknikat e qepjes së përkohshme (ildisjes);
- Të përshkruajë teknikat e qepjeve të përhershme;
- Të përshkruajë mënyrën e qepjes dhe të hekurosjes së pencave;
- Të përshkruajë mënyrat e manipulimit të pencave;
- Të listojë teknikat e qepjes të llojeve të ndryshme të xhepave;
- Të përshkruajnë teknikat e qepjes së filetove, rrudhave, palave, fluturave;
- Të përshkruajë teknikat e qepjes së jakave;
- Të përshkruajë teknikat e qepjes së zinxhirëve;
- Të rendisë hapat e qepjes së fundit të thjeshtë;
- Të rendisë hapat e qepjes së bluzës së thjeshtë;
- Të rendisë hapat e qepjes së këmishës së thjeshtë;

- Të përshkruajë teknikat e qepjes së mëngëve të thjeshta;
- Të rendisë hapat e qepjes së pantallonave të thjeshta;
- Të rendisë hapat e qepjes së fustanit të thjeshtë;
- Të përshkruajë mënyrën e përgatitjes së filetove dhe të qepjeve me to;
- Të përshkruajë teknikat e përgatitjes dhe të qepjes së mostrave;
- Të përshkruajë teknikat e qepjes së hapjes (çikat) së mëngëve, të përgatitjes së kapakëve, manshetave dhe të qepjes së tyre në mëngë;
- Të përshkruajë teknikat e përgatitjes dhe të qepjes së qemerëve;
- Të rendisë hapat e qepjes së artikujve të thjeshtë prej lëkure;
- Të përshkruajë teknikat e realizimit të provës;
- Te listojë llojet e defekteve gjatë qepjes;
- Te përshkruajë mënyrat e korigjimit të defekteve pas provës;
- Të listojë mjetet për shënimet e palës;
- Të përshkruajë elementët përbërës dhe rëndësinë e leximit të skedës teknike;
- Të rendisë teknikat e kthimit dhe qepjes së palës së veshjeve;
- Të përshkruajë mënyrat e shënimit mbi tekstil të pozicionit të birave, kopsave, elementëve të tjerë bashkues;
- Të përshkruajë mënyrat e punimit të birave të kopsave;
- Të përshkruajë mënyrat e qepjes së kopsave dhe/ose elementëve të tjerë bashkues;
- Të përshkruajë llojet dhe mënyrat e qepjes së elementëve zbukurues;
- Të përshkruajë mënyrat e vendosjes së etiketave në produkt;
- Të listojë mënyrat, mjetet dhe llojet e paketimit të produktit.

Procese ndihmëse (Hekurosje dhe Frazelim)

- Të përshkruajë teknikat e hekurosjes;
- Të përshkruajë mënyrën e përgatitjes së mjeteve për hekurosje në përshtatje me llojin e tekstilit;
- Të përshkruajë llojet e fortesave, funksionin dhe përdorimin e tyre;
- Të përshkruajë llojet e frazelinave, funksionin dhe përdorimin e tyre;
- Të përshkruajë rëndësinë e përzgjedhjes së frazelinës sipas llojit të tekstilit;
- Të listojë mënyrat e vendosjes dhe ngjitjes së frazelinës mbi tekstil;
- Të listojë mjetet dhe pajisjet për ngjitjen e frazelinës, funksionimin dhe përdorimin e tyre;
- Të listojë llojet e defekteve gjatë hekurosjes dhe frazelinimit.

Riparime dhe modifikime të thjeshta

- Të përshkruajë rëndësinë dhe mënyrat e identifikimit të defekteve në produkt;
- Të klasifikojë llojet dhe përdorimin e elementeve dekorues;
- Të përshkruajë mjetet dhe teknikat e modifikimit të produkteve;
- Të përshkruajë llojet, mjetet dhe mënyrat e riparimeve të thjeshta me dorë;
- Të përshkruajë llojet dhe mënyrat e riparimeve të thjeshta me makinë;

- Të përshkruajë mënyrat dhe mjetet e riparimeve me elemente dekorues.

Mjetet, pajisjet dhe makineritë e punës

- Të listojë mjetet dhe pajisjet e punës së rrobaqepësit dhe mënyrën e përdorimit të tyre;
- Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e makinave të qepjes së drejtë;
- Të përshkruajë funksionimin e makinave të qepjes tegel zig-zag;
- Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e makinave të qepjes tegel syzator;
- Të përshkruajë pjesët kryesore përbërëse dhe funksionimin e makinave të qepjes birë-kopsë;
- Të përshkruajë funksionimin e mjeteve dhe pajisjeve të hekurosjes;
- Të përshkruajë pjesët kryesore dhe funksionimin e makinave të prerjes së pëlhurave;
- Të përshkruajë pjesët kryesore dhe funksionimin e pajisjeve të prerjes së lëkurëve;
- Të përshkruajë funksionimin e makinave të qëndisjes;
- Të përshkruajë pjesët përbërëse të makinave të qepjes së trikotazheve;
- Të përshkruajë disa nga defektet e thjeshta të makinave qepëse;
- Të përshkruajë rregullat e mirëmbajtjes së makinave të tekstil-konfeksioneve.

Estetika në veshje

- Të përshkruajë rëndësinë e ngjyrave në veshje;
- Të listojë ngjyrat e para, të dyta dhe të treta;
- Të përshkruajë ngjyrat e ftohta dhe të ngrohta;
- Të përshkruajë kombinimet dhe kontrastin e ngjyrave;
- Të përshkruajë veçoritë dhe dallimet e skicës artistike dhe skicës teknike të veshjeve;
- Të rendisë llojet e aksesorëve funksionalë dhe aksesorëve dekorativë në veshje;
- Të përshkruajë shumëllojshmërinë e materialeve dhe kombinimet e tyre që përdoren për aksesorët e veshjeve;
- Të përshkruajë karakteristikat e veshjeve për fëmijë sipas modelit, formës, ngjyrave dhe materialeve;
- Të përshkruajë llojet e ndryshme të veshjeve sipas stileve (sportive, klasike, të përditshme, mbrëmjeshe dhe rastesh, pune, etj.);
- Të përshkruajë karakteristikat e veshjeve popullore.

Sigurimi teknik dhe mbrojtja e mjedisit

- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit sipas standardeve dhe legjislacionit shqiptar;
- Të listojë rregullat e sigurimit teknik në përdorimin e makinave në tekstil konfeksion;
- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të manualeve të mjeteve, pajisjeve dhe makinerive të punës;
- Të rendisë mënyrat e sistemimit të vendit të punës para, gjatë dhe pas punës;
- Të listojë rregullat për ndarjen e mbeturinave sipas llojit;

- Të përshkruajë rregullat përkatëse për depozitimin e mbetjeve nga procesi i punës;
- Të rendisë protokollet e duhura në raste pandemie;
- Të listojë procedurat e evakuimit për raste emergjence;
- Të përshkruajë rregullat e shpëtimit dhe mbrojtjes ndaj zjarrit;
- Të listojë llojet e mjeteve të ndihmës së parë dhe përdorimit të tyre;
- Të listojë procedurat e dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti;
- Të shpjegojë rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit;
- Të tregojë rëndësinë e njohjes dhe zbatimit të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.

SHPREHI PROFESIONALE

Në përfundim të kualifikimit profesional “Tekstil-konfeksione” niveli II në KSHK, referuar niveli II të KEK, individi zotëron shprehinë profesionale si më poshtë:

Komunikimi, etika profesionale dhe edukimi i karrierës

- Të marrë informacionin e duhur para fillimit të punës nga specialisti;
- Të zbatojë parimet kryesore të etikës profesionale në punë;
- Të komunikojë në mënyrë etike me kolegë dhe eprorë;
- Të zbatojë parimet e punës në grup;
- Të zbatojë rregullat e higjienës dhe mirëmbajtjes së mjeteve të punës, pajisjeve dhe vendit të punës;
- Të zbatojë rregullat e përdorimit të mjeteve, pajisjeve dhe makinerive në repartet e prodhimit;
- Të përditësojë informacionin mbi zhvillimin e industrisë së tekstileve;
- Të përdorë TIK në marrëdhënie pune.

Tekstile për veshje dhe artikuj të tjerë

- Të dallojë llojet e fibrave dhe karakteristikat e tyre;
- Të identifikojë produktet e marra nga fibrat;
- Të dallojë fillin, karakteristikat dhe përdorimet e tij;
- Të realizojë thurje dhe endje të thjeshta;
- Të dallojë llojet kryesore të thurjeve të makinave të tezgjahut;
- Të dallojë llojet kryesore të thurjeve të makinave të trikotazhit;
- Të zbatojë teknika të thjeshta të ngjyimit të tekstileve;
- Të zbatojë teknika të thjeshta të stampimit të pëlhurave;
- Të kryejë teknika të thjeshta të manipulimit të tekstileve;
- Të dallojë anën e përparme të pëlhurave;
- Të identifikojë llojet e defekteve në tekstile;
- Të dallojë llojet e lëkurëve.

Bazat e modelimit

a. Matjet

- Të dallojë pikat antropometrike të trupit të njeriut sipas standardit;
- Të identifikojë proporcionet e trupit të njeriut;
- Të dallojë diferencat e gjatësisë shpinë-përparëse gjatë matjeve të tyre;
- Të zbatojë mënyrat e marrjes së përmasave të trupit të njeriut;
- Të dallojë format dhe defektet në trupin e njeriut;
- Të përdorë elementët e tabelave të masave;
- Të identifikojë pikat bazë për marrjen e përmasave të artikujve të tjerë sipas standardeve përkatës;
- Të zbatojë mënyrat e marrjes së përmasave të artikujve të tjerë.

b. Ndërtimi kallëpeve

- Të zbatojë mënyrat e llogaritjes së sasisë së nevojshme të materialeve për ndërtimin e skicave;
- Të llogarisë përmasat e artikujve/objekteve;
- Të interpretojë tabelat e masave;
- Të përfshijë tolerancat e lirshmërisë në llogaritje;
- Të vendosë tolerancat e qepjes në skicën përkatëse;
- Të zbatojë teknikat e duhura të vendosjes së shenjave orientuese;
- Të zbatojë mënyrat e skicimit të qemerëve;
- Të zbatojë mënyrat e skicimit të xhepave dhe kapakëve;
- Të zbatojë mënyrat e skicimit të fundeve;
- Të zbatojë mënyrat e skicimit të pantallonave;
- Të zbatojë mënyrat e skicimit të busteve;
- Të zbatojë mënyrat e skicimit të mëngës së thjeshtë;
- Të zbatojë mënyrat e skicimit të jakave;
- Të zbatojë mënyrat e skicimit të këmishëve;
- Të zbatojë mënyrat e skicimit të fustanit;
- Të zbatojë mënyrat e skicimit për artikuj të tjerë (perde, çanta, kapele, doreza etj.);
- Të dallojë llojet bazë të manekinëve;
- Të zbatojë mënyrat e përgatitjes së pëlhurës direkt në manekinë (mulazh);
- Të zbatojë mënyrat e llogaritjes së tolerancave për artikuj të tjerë;
- Të vendosë shenjat orientuese mbi skicat e artikujve të tjerë.

c. Prerja

- Të identifikojë teknikat e prerjes së tekstilit në bazë të llojit të tekstilit, trashësisë së tij dhe sasisë së produktit;
- Të realizojë ekonomizimin e tekstilit duke respektuar drejtimin e vendosjes së skicave mbi tekstil;

- Të kryejë vendosjen/pozicionimin e tekstilit në funksion të produktit;
- Të kryejë palosjen e tekstilit për produktin;
- Të kryejë vendosjen dhe fiksimin e kallëpit mbi tekstile;
- Të realizojë prerjen e tekstilit me gërshërë;
- Të realizojë prerjen e tekstilit me sharrë dore duke respektuar rregullat e sigurimit teknik;
- Të përzgjedhë mjetet e duhura të punës për prerjen e tekstilit sipas kallëpit.

Qepja dhe proceset përfundimtare

- Të përzgjedhë mjetet dhe materialet në proceset e qepjes me dorë sipas llojit të tekstilit;
- Të identifikojë punime me dorë (penj-kopjues apo pasi, ildisja, zig-zag, neverti, punimi i birave, qepja e kopsave);
- Të përgatisë makinën qepëse dhe vendin e punës sipas proceseve;
- Të realizojë teknikat e qepjes së përkohshme (ildisjes);
- Të realizojë teknikat e qepjeve së përhershme;
- Të zbatojë mënyrat e qepjes dhe të hekurosjes së pencave;
- Të realizojë mënyrat e manipulimit të pencave;
- Të zbatojë teknikat e qepjes të llojeve të ndryshme të xhepave;
- Të zbatojë teknikat e qepjes së filetove, rrudhave, palave, fluturave;
- Të zbatojë teknikat e qepjes së jakave;
- Të zbatojë teknikat e qepjes së zinxhirëve;
- Të realizojë hapat e qepjes së fundit të thjeshtë;
- Të realizojë hapat e qepjes së bluzës të thjeshtë;
- Të realizojë hapat e qepjes së këmishës të thjeshtë;
- Të zbatojë teknikat e qepjes së mëngëve të thjeshta;
- Të realizojë hapat e qepjes së pantallonave të thjeshta;
- Të realizojë hapat e qepjes së fustanit të thjeshtë;
- Të përgatisë fileton dhe të realizojë qepjen e tyre;
- Të përgatisë dhe të realizojë qepjen e mostrave;
- Të përgatisë çikat e mëngëve, kapakët, manshetat dhe t'i montojë ato në mëngë;
- Të kryejë përgatitjen dhe qepjen e qemerëve;
- Të qepë artikuj të thjeshtë prej lëkure;
- Të zbatojë teknikat e realizimit të provës;
- Të identifikojë llojet e defekteve gjatë qepjes;
- Të kryejë korrigjimet/modifikimet e duhura të defekteve pas provës;
- Të kryejë shënimet e palës duke përdorur mjetet përkatëse;
- Të identifikojë elementët përbërës të skedës teknike;
- Të realizojë llojet dhe mënyrat e kthimit dhe qepjes e palës së veshjeve me dorë ose makinë;
- Të vendosë shënimet mbi tekstil të pozicionit të birave, kopsave, elementëve të tjerë bashkues;
- Të realizojë mënyrat e punimit të birave të kopsave me dorë ose me makinë;

- Të realizojë mënyrat e qepjes së kopsave dhe elementëve të tjerë bashkues;
- Të realizojë mënyrat e qepjes së elementëve zbukurues;
- Të realizojë mënyrat e vendosjes së etiketave ne produkt;
- Të përdorë mënyrat, mjetet dhe llojet e paketimit të produktit.

Procese ndihmëse (Hekurosje dhe Frazelim)

- Të zbatojë teknikat e hekurosjes sipas llojit të tekstilit dhe produktit;
- Të përgatitë mjetet për hekurosje në përshtatje me llojin e tekstilit;
- Të identifikojë llojet e fortesave sipas funksionit dhe përdorimit të tyre;
- Të dallojë llojet e frazelinave sipas funksionit dhe përdorimit të tyre;
- Të përzgjedhë frazelinën sipas llojit të tekstilit;
- Të zbatojë mënyrat e vendosjes dhe ngjitjes së frazelinës mbi tekstil;
- Të përdorë mjetet dhe pajisjet për ngjitjen e frazelinës;
- Të dallojë llojet e defekteve gjatë hekurosjes dhe frazelinimit.

Riparime dhe modifikime të thjeshta

- Të identifikojë defektet në produkt;
- Të përdorë elementet dekorues për zbukurime, modifikime apo riparime;
- Të përzgjedhë mjetet dhe teknikat e modifikimit të produkteve;
- Të përdorë mjetet dhe mënyrat e duhura për riparime të thjeshta me dorë;
- Të kryejë riparime të thjeshta me makinë.

Mjetet, pajisjet dhe makineritë e punës

- Të identifikojë pjesët përbërëse kryesore të makinës qepëse familjare me tegel të drejtë;
- Të përgatitë për punë makinën e qepjes;
- Të identifikojë llojet e gjilpërave sipas llojit të makinës dhe materialit të përdorur;
- Të përzgjedhë fillin në varësi të llojit të tekstilit;
- Të përdorë makinën qepëse familjare me tegel të drejtë;
- Të identifikojë pjesë përbërëse kryesore të makinës qepëse industriale me tegel të drejtë;
- Të përdorë makinën qepëse industriale me tegel të drejtë;
- Të kryejë shërbime të thjeshta në makinën qepëse me tegel të drejtë familjare dhe industriale (ndërrim vaji, pastrim, ndërrim fijesh, mbushje e bobinës, lirimi dhe shtrëngimi i fillit);
- Të përdorë makinën qepëse në punime zig-zag;
- Të identifikojë pjesë përbërëse kryesore të makinës qepëse syzator;
- Të përgatitë për punë makinën qepëse syzator;
- Të përdorë makinën qepëse syzator;
- Të kryejë shërbime në makinën qepëse syzator (ndërrim vaji, pastrim, ndërrim fijesh, lirimi dhe shtrëngimi i fillit, ndërrimi i gjilpërës, ndërrimi i këmbëzës qepëse);
- Të identifikojë pjesë përbërëse kryesore të makinës të qepjes së bir-kopsave;

- Të përgatitë për punë makinën e qepjes së bir-kopsave;
- Të kryejë shërbime në makinën e qepjes së bir-kopsave (ndërrim vaji, pastrim, ndërrim fijesh, lirimi dhe shtrëngimi i fillit);
- Të përdorë makinën e qepjes së bir-kopsave;
- Të përdorë mjetet dhe pajisjet për hekurosje;
- Të përzgjedhë pajisjet ndihmëse të nevojshme për procesin e hekurosjes;
- Të identifikojë pjesë përbërëse kryesore të makinave të prerjes së pëlhurave;
- Të përdorë mjetet prerëse të lëkurëve;
- Të përdorë makinën e qëndisjes;
- Të realizojë qepje të trikotazhit me makinën përkatëse;
- Të përdorë makinën e qepjes së lëkurës;
- Të rregullojë defekte të thjeshta gjatë procesit të qepjes në makinat qepëse.

Estetika në veshje

- Të dallojë ngjyrat e para, të dyta dhe të treta;
- Të dallojë ngjyrat e ftohta dhe të ngrohta;
- Të identifikojë kontrastin e ngjyrave;
- Të kryejë kombinime të thjeshta;
- Të identifikojë veçoritë dhe dallimet e skicës artistike dhe skicës teknike të veshjeve;
- Të përzgjedhë llojet e aksesorëve funksionalë dhe aksesorëve dekorative në veshje;
- Të dallojë shumëllojshmërinë e materialeve dhe kombinimet e tyre që përdoren për aksesorët e veshjeve;
- Të identifikojë karakteristikat e veshjeve për fëmijë sipas modelit, formës, ngjyrave dhe materialeve;
- Të identifikojë llojet e ndryshme të veshjeve sipas stileve (sportive, klasike, të përditshme, mbrëmjeje, raste pune, etj.);
- Të identifikojë karakteristikat e veshjeve popullore.

Sigurimi teknik dhe mbrojtja e mjedisit

- Të zbatojë legjislacionin në fuqi për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjen e mjedisit;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në përdorimin e makinave në tekstil konfeksion;
- Të zbatojë manualët e mjeteve, pajisjeve dhe makinerive të punës;
- Të përgatitë vendin e punës para, gjatë dhe pas punës;
- Të zbatojë rregullat për ndarjen e mbetjeve sipas llojit;
- Të zbatojë rregullat përkatëse për depozitimimin e mbetjeve nga procesi i punës, në përputhje me rregulloret e mjedisit;
- Të zbatojë protokollet e duhura në raste pandemie;
- Të zbatojë planin e evakuimit për raste emergjence;

- Të zbatojë rregullat e shpëtimit dhe mbrojtjes ndaj zjarrit;
- Të përdorë mjetet e ndihmës së parë;
- Të japë ndihmën e parë në rast aksidenti;
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit.

KOMPETENCA TE PERGJITHSHME

Individi duhet të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale e rajonale;
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij;
- Të organizojë drejt procesin e të nxënës të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij;
- Të demonstrojë sjellje dhe qëndrime etike në veprimtaritë shkollore dhe në komunitet;
- Të demonstrojë aftësinë për të pranuar dhe promovuar ndryshimin dhe inovacionin;
- Të demonstrojë aftësinë për të komunikuar dhe negociuar idetë në mënyrë eficiente me të tjerët;
- Të demonstrojë aftësinë për të menduar në mënyrë krijuese dhe novatore;
- Të demonstrojë aftësinë për të identifikuar dhe për të zgjidhur në mënyrë krijuese problemet.